



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/52

Datë: 07.10.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 7 Tetor 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet 46 dhe 47 të Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/52

Datë: 07.10.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 7 Tetor 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Strategjia Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015-2025, dhe Planit i veprimit 5 vjeçar.
2. Obligohet Ministria e Infrastrukturës dhe Institucionet tjera kompetente, për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/52

Datë: 07.10.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 7 Tetor 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për Shërbime Ajrore, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Shtetit të Katarit.
2. Përgjatë negociimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet Ministria e Infrastrukturës që të procedoj konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, dhe dispozitave tjera përkatëse në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/52


Datë: 07.10.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 7 Tetor 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Financave për lidhjen e Marrëveshjes plotësuese ndërkombëtare, në vlerë prej 4 milion euro, me Bankën Gjermane për Zhvillim (KfW) për projektin "Përmirësimi i sistemit të ngrohjes komunale"
2. Përgjatë negociimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet Ministria e Financave që të procedoj konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, dhe dispozitave tjera përkatëse në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 05/52

Datë: 07.10.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet nr. 03/L-221, 04/L-165, nr. 04/L-194, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 7 Tetor 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 150,000 (njëqindpesëdhjetë mijë) euro, për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, nga nën-programi - Shpenzimet e paparashikuara me kod 131.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen për nën-programin "Investime kapitale në arsimin para universitar" me kod 208-981, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale, edhe atë:
  - 100,000 euro për projektin Ndërtimi i shkollës fillore "Shefki Kuleta" në fshatin Halabak, Podujevë;
  - 50,000 euro për projektin me kod 10331 "Blerja e inventarit dhe pajisjeve laboratorike".
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 06/52

Datë: 07.10.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 9 të Ligjit Nr. 05/L-046 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 05/L-001, për Buxhetin e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 7 Tetor 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjetet financiare në vlerë prej 7,376.54 (shtatë mijetëqind e shtatëdhjetë gjashtë euro, e pesëdhjetë katër cent), për komuna.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen si vijon:
  - 2.1. 5,843.18 euro Komunës së Mitrovicës së Veriut, me kod organizativ 647, nën programi Zyra e Kuvendit Komunal, me kod 16938, kategoria ekonomike paga dhe mëditje;
  - 2.2. 863.50 euro Komunës së Klllokotit, me kod organizativ 660, nën programi Prokurimi, me kod 16880, kategoria ekonomike paga dhe mëditje;
  - 2.3. 379.64 euro Komunës së Junikut, me kod 636, programi Shëndetësia dhe Mirëqenia, me kod 730, nën programi Administrata, me kod 73029, kategoria ekonomike paga dhe mëditje;
  - 2.4. 117.10 euro Komunës së Junikut, me kod 636, programi Arsimi dhe Shkenca, me kod 920, nën programi Administrata, me kod 92100, kategoria ekonomike paga dhe mëditje;
  - 2.5. 173.12 euro Komunës së Zubin Potokut, me kod 645, nën programi Administrata, me kod 16325, kategoria ekonomike paga dhe mëditje.
3. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Ministria e Financave, me kod organizativ 201, nën-programi Kontigjenca për Paga, për pagesën e përvojës së punës, me kod 285.
4. Obligohet Ministria e Financave dhe Komunitat e ndikuara për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/52

Datë: 07.10.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 7 Tetor 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës aprovon Informatën e Ministrit të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, lidhur me konferencën e dytë rajonale, e mbajtur në Mali të Zi, me datë 21 dhe 22 shtator 2015.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë